

02.04.2021
Ora 11:04

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Për pranimin për shyrtim të kërkesës ankimore nr.8, me objekt "Kundërshtim i vendimit nr.198, dt.01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e përmbytjes së fletës së votimit per zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021" subjekti ankues Partia Socialiste".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA,
Z.Ilirjan RUSMALI
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, A.Llano
- **Parti Politike:** PS, BD

Z. K. Bele: Mirë, besoj jemi gati. Çelimi sot seancën e publike të Komisionit Ankimimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbytjes të ankimit nr.8 të subjektit ankues Partia Socialiste e Shqipërisë në objekt "Kundërshtimin e vendimit nr.198 datë 01.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve". Relatori i kësaj seance jam zgjedhur unë Koli Bele sipas shortit të hedhur sot në datën 02.04.2021, në orën 09:00 për ekonomi u caktua një seancë e shpejtë. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS, Sekretari i Përgjithshëm dhe përfaqësuesi i ankuesit, Partisë Socialiste. Palë të tjera të pranishme? Palë të interesuar kemi?

Z. Y. Merkaj: Po zoti Relator. Kemi njoftuar partitë politike të cilat mund kishin interes të ligjshëm për seancën e sotme. Nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë deri tani.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.04.2021*

Z. K. Bele: Po, mirë ato pavarësisht janë në kohë që të paraqiten dhe në seancë nëse çështja kalon për shqyrtim kështu që, nuk do të humbasin ndonjë të drejtë nga kjo mos prezencë. Ftojme Sekretarin e Përgjithshëm për një paraqitje të shkurtër të rrethanave të çështjes.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, Presidenti i Republikës ka caktuar datën 25 Prill për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend të Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në përfundim të afatit të regjistrimit të listave shumëemërore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë regjistruar gjithsej 2 koalicione dhe 10 parti politike si edhe 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit. Në përfundim të procesit të regjistrimit të listave shumëemërore Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka organizuar hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedh nga neni 98 i Kodit Zgjedhor si dhe ka miratuar rezultatin e shortit për caktimin e numrit rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit. Gjithashtu në zbatim të dispozitave të mësipërme, Komisioneri me vendim ka zhvilluar seancën për miratimin e listave shumëemërore për 12 qarqet dhe në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.198, datë 01.04.2021 ka vendosur të miratojë fletët e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 me përmbajtje sipas shkresave specifike për çdo qark në formatin landscape duke përshtatur sipas numrit të kandidatëve madhësinë e frontit dhe stilizimin e logove si më poshtë vijon, domethënë për të gjitha Qarku Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Kundër këtij vendimi duke qenë se në seancën e shqyrtimit ka pasur pretendim nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste pasi ka kërkuar me vendim të.. në shqyrtim ka kërkuar që në fletën e votimit kandidatët të jenë të shënuar sipas numri rendor në listën shumëemërore të paraqitur prej tyre dhe të jenë me numër. Ndërsa Partia Demokratike ka pretenduar.. ka paraqitur kërkesën që modeli i fletës së votimit që do të miratohet të jetë në formatin portret, Komisioneri ka vendosur që të jetë në formatin landscape. Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.04.2021*

nr.198, datë 01.04.2021 ka paraqitur ankesë Partia Socialiste në datën 01.04.2021. Duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, miratimin e fletës së votimit për 12 qarqet në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas variantit ku në përmbajtjen e fletës së votimit kandidatët të identifikohen me numra. Në datën 02.04.2021 është hedhur shorti për caktimin e relatorit, ku relatori i kërkesave ankimore nr.8 është zoti Koli Bele. Bashkëlidhur keni të gjithë dokumentacionin për veprimet paraprake, faleminderit.

Z. K. Bele: Duke patur parasysh që kjo kërkesë nuk ka të bëjë me shqyrtimin e themelit të çështjes dhe me përmbushjen e kriterëve formale të ankimit, nëse ankuesi ka ndonjë.. dëshiron të thotë ndonjë gjë lidhur me element të formës dhe përmbajtjes së ankimit, kompetencën etj. nëse jo?

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Jo, nuk kemi.

Z. K. Bele: Ndonjë pyetje nga anëtarët?

Z. L. Braho: Pyetja është dhe për administratën dhe për përfaqësuesit e ankuesit. Bashkëlidhur me dokumentat ka ardhur dhe ky modeli i fletës së votimit. Ky është modeli i fletës së votimit që kërkohet të pranohet me ankim?

Z. Y. Merkaç: Po. Atëherë..., po.

Z. L. Braho: Dakord, kaq kisha.

Z. K. Bele: Më fal vetëm në plotësim të kësaj, sepse edhe unë e kisha menduar si kërkesë në fakt jo si pyetje si kërkesë që do t'ia drejtoja administratës që në plotësim të dokumentacionit që do të na vijë ne për shqyrtim do të lutesha që të

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.04.2021*

printohen fletët. Pra, si ato që ka vendosur Komisioneri në vendimin e tij i kemi të printuara po do të doja që të ishin të printuara në formatin real, sepse do të na ndihmonte të kuptonim më shumë lidhur me qëndrimet dhe pretendimet e palëve. E njëjta gjë dhe për atë që ka depozituar ankuesi që në kuptueshmërinë time është një fletë ose një nga variantet që ka paraqitur administrata. Do të doja që këto..., një kopje për të paktën një kopje që ne të kemi vizualisht idenë se për çfarë flitet.

Z. Y. Merkaç: Atëherë, në përmasat reale në qoftë se do të flasim për fletën e votimit që është dorëzuar me numra është me përmasat reale siç është paraqitur propozimi nga Komisioneri. Ndërsa fletët e votimit që ka miratuar Komisioneri janë në formatin 297 cm me 600 cm. Kështu që, do t'ia paraqesim në vazhdim.

Z. K. Bele: Të ketë format real kjo është ideja pastaj ato janë teknikalitete.. *(nuk dëgjohet)* Dakord. *(nuk dëgjohet)* Mirë, faleminderit.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Për një shtesë. Për sa i përket formatit me numra është pjesë e shqyrtimit administrativ fletët origjinale sepse po shikoj këto që janë printime pangjyra dhe logot janë proces administrativë. Pra, dosja që ju shqyrtuat dje do ta ketë Komisioni dhe aty është linja reale e fletës dhe këto janë pa ngjyra.

Z. Y. Merkaç: Atëherë, vetëm njëra është me ngjyra. Pjesa tjerë është fotokopjuar.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Po mirë, ajo është pjesë e dosjes. Këtë e kemi për prova kurse pjesë e dosjes duhet të jetë origjinali. Shqyrtimi administrativ i cili u zhvillua dje i ka origjinale dhe fletët pra, sepse një dosje, një kopje origjinale ka dhe fletët të cilat miratoi Komisioneri dhe fletët të cilat ju si administratë kishit printuar me numra.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.02.04.2021*

Z. K. Bele: Avokat pa problem, sepse kam bindjen që dosja administrative bashkë me procesverbalin e seancës do të jetë e plot në shqyrtimin e kësaj çështjeje kur të shqyrtohet themeli. KAS po tërhiqet për vendim lidhur me kërkesën, lidhur me momentin e kalimit në shqyrtim dhe do t'iu njoftojmë shumë shpejt për..

Rifillon seanca
Ora 11:18

Z. K. Bele: Mirë, KAS-i vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim dhe seanca është caktuar për nesër në orën 11:00, faleminderit.

Vendimi nr.14

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*

